



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 140, datë 28.09.2023

**PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË APARATIT
TË BASHKISË SË DurrësIT**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b”, e nenit 54 shkronja “ç”, nenit 55, pika 2, të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar; Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 113 të Ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; nenit 6, shkronja “c” dhe nenit 9, të Ligjit nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 150, datë 22.12.2022 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023, si dhe projektbuxhetin Afat Mesëm 2023-2025”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e nivelit të pagave për funksionarët e zgjedhur, nëpunësit civilë dhe punonjësit administrativë të Aparatit të Bashkisë së DurrësIT, detajuar si më poshtë vijon:
- 1.1. Miratimin e nivelit të pagave për funksionarët e zgjedhur të Aparatit të Bashkisë së DurrësIT, si më poshtë vijon:

Emërtimi	Paga bruto mujore
Kryetari i Bashkisë	185.000 lekë
Nënkryetar	160.000 lekë

1.2. Miratimin e nivelit të pagave për funksionarët e kabineteve dhe nëpunësve civilë të Aparatit të Bashkisë së Durrësit, si më poshtë vijon:

Nr.	Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori	Kategoria	Paga për pozicion
1	Drejtor i Kabinetit	II-b	91 000
2	Këshilltar i Kryetarit	III-a/1	73 900
3	Sekretar i Këshillit Bashkiak	II-b	91 000
4	Drejtor Drejtorie	II-b	91 000
5	Zëdhënës Shtypi	III-a/1	73 900
6	Përgjegjës Sektori	III-a	80 300
7	Specialist	III-b	70 000
8	Specialist panë Drejtorisë së MZSH-së	III-b	70 000

- Shtesa për vjetërsi në punë për kategoritë në tabelën e sipërcituar, të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi shtesën e nivelit të kualifikimit.
- Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit për çdo grup diplome, është si më poshtë vijon:

Grupi i diplomës	Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK)	Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit
1	Niveli 7 i KSHK-së (Master i shkencave. Master i arteve. Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	14 000 lekë
2	Niveli 7 i KSHK-së (Master profesional. Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	12 000 lekë
3	Niveli 6 i KSHK-së (Bachelor. Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	10 000 lekë

1.3. Miratimin e nivelit të pagave për Administratorët e Lagjeve dhe Njësive Administrative si më poshtë vijon:

Nr.	Emërtesa e Pozicioneve	Paga bruto mujore
1	Administrator i Njësia Administrative Sukth	109.000 lekë
2	Administrator i Njësia Administrative Manëz	95.000 lekë

3	Administrator i Njësia Administrative Ishëm	95.000 lekë
4	Administrator i Njësia Administrative Katundi i Ri	95.000 lekë
5	Administrator i Njësia Administrative Rrashbull	109.000 lekë
6	Administrator i Lagjes nr. 1	109.000 lekë
7	Administrator i Lagjes nr. 2	109.000 lekë
8	Administrator i Lagjes nr. 3	109.000 lekë
9	Administrator i Lagjes nr. 4	139.000 lekë
10	Administrator i Lagjes nr. 5	139.000 lekë
11	Administrator i Lagjes nr. 6	109.000 lekë



1.4 Miratimin e nivelit të pagave për punonjësit administrativ të Aparatit të Bashkisë së Durrësit, si më poshtë vijon:

1.4.1. Për punonjësit administrativë (roje, mirëmbajtës, shofer, magazinier, inspektor tregu, punonjës pastrimi) të Aparatit të Bashkisë Durrës, paga mujore të jetë sipas tabelës së mëposhtëme:

Nr	Emërtimi	Shtesa për vjetërsi në %	Paga Bazë
1	Punonjës administrative (roje, mirëmbajtës, shofer, magazinier, inspektor tregu, punonjës pastrimi).	1%	47 000

- Shtesa për vjetërsi në punë për tabelën e sipërcituar për punonjësit administrativë (roje, mirëmbajtës, shofer, magazinier, inspektor tregu, punonjës pastrimi) të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën bazë.

1.4.2. Për punonjësit e projektit të arkivës, të cilët janë me kontratë me afat të përcaktuar paga bruto mujore do të jetë 40 000 lekë.

1.5. Për punonjësit e Sektorit të Informatikës dhe Teknologjisë së Shërbimit do të ketë një shtesë për kushte pune (natyrë të veçantë pune) prej 7500 lekë në muaj, në përputhje me përcaktimet e pikës 4 të Vendimit nr.328, datë 31.05.2023.

1.6 Miratimin e shpërblimit mujor të Këshilltarëve të Këshillit Bashkiak në masën 10 % të pagës mujore të Kryetarit të Bashkisë.

1.7 Miratimin e shpërblimit mujor të Këshilltarëve të Kryetarit të Bashkisë me kohë të pjesëshme në masën 40,000 lekë.

1.8 Miratimin e shpërblimit mujor të Kryetarëve të fshatrave në masën 10 % të pagës së Administratorit të Njësia Administrative përkatëse.

- 2 Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi fillojnë nga data 1 prill 2023 dhe përballohen nga fondet e lira të krijuara si pasojë e vakancave të vitit 2023, si dhe nga fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për rritjen e pagave në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”,

3 Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ekonomike.

- 4 Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.111, datë 27.10.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të aparatit të Bashkisë së Durrësit” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 28.09.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 628/3 Prot.

Durrës, më 05.10.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërise së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.140 datë 28.09.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të aparatit të bashkisë së Durrësit”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

